



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
P-049
Prishtinë, më 30 nëntor 2015,

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 30 NËNTOR 2015**

Seancën e kryesoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Xhavit HALITI, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Para se të procedohet me pikat e rendit të ditës, deputetët e grupeve parlamentare të opozitës tentuan të dalin para foltores së Kuvendit dhe para ulëses së kryetarit të Kuvendit, por ata u penguan nga pjesëtarët e sigurimit.

Deputetë nga radhët e grupeve parlamentare opozitare hodhën gaz lotsjellës në sallën e seancës plenare të Kuvendit.

Në këto rrethana, kryetari e ndërpreu seancën dhe e thirri mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare.

* * *

Pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, seanca plenare i vazhdoi punimet në sallën kryesore të seancave plenare.

Deputetët e grupeve parlamentare të opozitës nuk ishin të pranishëm në sallë.

Në vazhdim, kryetari procedoi me pikat e rendit të ditës si në vijim:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës nuk pati asnjë deputet të paraqitur për fjalë.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Bekim Haxhiu parashtoi pyetje për zv/kryeministrin Kujtim Shala në lidhje me ngecjen në realizimin e projekteve në lëmin e sportit, me theks në atë të futbollit dhe rrezikimin e zhvillimit të ndeshjeve kualifikuese të reprezentacionit të Republikës së Kosovës, të cilat duhet të mbahen në shtator të vitit 2016, në ndërkohë që pritet që Kosova të anëtarësohet në UEFA në mars të vitit 2016.

Zv/kryeministri Kujtim Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Bekim Haxhiu.

Deputeti Bekim Haxhiu parashtoi pyetje për ministrin Imet Rrahmani në lidhje me krijimin e kushteve, bartjen e kompetencave dhe grumbullimin e mjeteve për funksionimin e odave të profesionistëve shëndetësorë.

Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetit Bekim Haxhiu.

Deputeti Nezir Çoçaj parashtoi pyetje për ministrin Lutfi Zharku në lidhje me mundësinë e qasjes së banorëve të Komunës së Mamushës në autostradë, në fshatin Novakë.

Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetit Nezir Çoçaj.

* * *

Në vazhdim, për plotësimin e rendit të ditës u paraqit deputeti Ismet Beqiri.

Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, propozoi që pika - Zgjedhja e një anëtari joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës të shtyhet për njërën nga seancat plenare të radhës.

Kryetari kërkoi deklarinimin e grupeve parlamentare lidhur me propozimin e lartpërmendur.

Në lidhje me propozimin e deputetit Ismet Beqiri u deklaruan deputetët: Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Slavko Simiq, në emër të Grupit Parlamentar LS; dhe Fikrim Damka, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari në vazhdim e hodhi në votim propozimin e deputetit Ismet Beqiri.

Kuvendi nëpërmjet një votimi formal miratoi propozimin e deputetit Ismet Beqiri.

* * *

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Kuvendi i miratoi pa asnjë vërejtje procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 15, 23 dhe 24 tetor 2015, më 2 nëntor 2015 dhe procesverbalin e seancës së jashtëzakonshme të mbajtur më 17 nëntor 2015.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut.

Ministri Imet Rrahmani tha se nëpërmjet këtij projektligji ratifikohet Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e bashkëpunimit për zhvillim: “KSV / 017: Programi për Mbështetjen e Shëndetësisë në Kosovë (Faza II)”.

Në vazhdim, ai u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit, për të cilin tha se përmban vetëm 4 nene.

Në fund, ministri i ftoi deputetët për miratimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut.

Fjala e ministrit Imet Rrahmani është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, lidhur me shqyrtimin e këtij projektligji, e paraqiti deputeti Naser Osmani.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Slavko Simiq, në emër të Grupit Parlamentar LS, dhe Fikrim Damka, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari sqaroi se miratimi i këtij projektligji kërkon së paku 80 vota për dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Kryetari më pas e hodhi në votim amendamentin e vetëm të propozuar nga Komisioni FunkSIONAL.

Kuvendi e miratoi amendamentin e vetëm të propozuar nga Komisioni FunkSIONAL.

Më tej, kryetari e hodhi në votim në tërësi Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 81,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 05/L-059 për ratifikimin e Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e bashkëpunimit për zhvillim: “KSV / 017: Programi për Mbështetjen e Shëndetësisë në Kosovë (Faza II)”.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim: “KSV/018: Mbështetje Institucionale dhe Teknike për Sistemin e Furnizimit me Ujë në Rajonin e Mitrovicës”

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim: “KSV/018: Mbështetje Institucionale dhe Teknike për Sistemin e Furnizimit me Ujë në Rajonin e Mitrovicës”.

Ministri Blerand Stavileci tha se nëpërmjet këtij projektligji ratifikohet Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim: “KSV/018: Mbështetje Institucionale dhe Teknike për Sistemin e Furnizimit me Ujë në Rajonin e Mitrovicës”.

Në vazhdim, ai u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit, për të cilin tha se përmban vetëm 4 nene.

Në fund, ministri i ftoi deputetët për miratimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim: “KSV/018: Mbështetje Institucionale dhe Teknike për Sistemin e Furnizimit me Ujë në Rajonin e Mitrovicës”. Fjala e ministrit Blerand Stavileci është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim: “KSV/018: Mbështetje Institucionale dhe Teknike për Sistemin e Furnizimit me Ujë në Rajonin e Mitrovicës”. Raportin me rekomandime, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, lidhur me shqyrtimin e këtij projektligji, e paraqiti deputeti Naser Osmani.

Kryetari sqaroi se miratimi i këtij projektligji kërkon së paku 80 vota për dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Më pas, kryetari hodhi në votim Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim: “KSV/018: Mbështetje Institucionale dhe Teknike për Sistemin e Furnizimit me Ujë në Rajonin e Mitrovicës”.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 80,

Kundër----- 0,

Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 05/L-056 për ratifikimin e Marrëveshjes Bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim: “KSV/018: Mbështetje Institucionale dhe Teknike për Sistemin e Furnizimit me Ujë në Rajonin e Mitrovicës”.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-116 dhe nr. 04/L-194

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-116 dhe nr. 04/L-194.

Ministri Avdullah Hoti tha se çështje kryesore e trajtuar në këtë projektligj është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit bazik për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Sipas ndryshimeve, rritja vjetore e buxhetit për paga dhe mëditje, krahasuar me buxhetin në fuqi, nuk mund ta tejkalojë normën e rritjes vjetore të bruto-prodhimit vendor.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Avdullah Hoti është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Slavko Simiq, në emër të Grupit Parlamentar LS; Fikrim Damka, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-116 dhe nr. 04/L-194.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 76,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin Nr. 05/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-116 dhe nr. 04/L-194.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin Funkcional për Buxhet dhe Financa, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij projektligji dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237.

Ministri Avdullah Hoti tha se ky projektligj kryesisht trajton modifikimin e çështjeve të prokurimit publik nëpërmjet freskimit të procedurave dhe mekanizmave ekzistues dhe inkuadrimit të mekanizmave dhe procedurave të reja.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Avdullah Hoti është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa; Labinotë Demi-Murtezi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Fatmir Rexhepi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Slavko Simiq, në emër të Grupit Parlamentar LS; Fikrim Damka, në emër të Grupit Parlamentar "6+", si dhe Gëzim Kelmendi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 67,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin nr. 05/L-063 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij projektligji dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Ministri Avdullah Hoti tha se ky projektligj rregullon organizimin, veprimtarinë dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, ky projektligj përcakton fushëveprimin për auditimin e jashtëm të fondeve publike, ekzekutimin e buxhetit, përdorimin dhe qeverisjen e burimeve publike, si dhe rrit nivelin e transparencës në funksionimin e Auditorit të Përgjithshëm.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Avdullah Hoti është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Naim Fetahu, në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, e paraqiti dhe e arsyetoi para Kuvendit raportin me rekomandime, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 67,

Kundër ----- 2,

Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij projektligji dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.

Ministri Arban Abrashi tha se ky projektligj përcakton funksionet dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Arban Abrashi është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Selvije Halimi, në emër të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit; Agim Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Slavko Simiq, në emër të Grupit Parlamentar LS, dhe Danush Ademi, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 68,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij projektligji dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës.

Ministri Arsim Bajrami tha se ky projektligj ka për qëllim përcaktimin e kriterëve për pjesëmarrje në disa profesione të rëndësishme, të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesit publik, të sigurisë publike dhe shëndetit, respektimin e parimeve të shqyrtimit të pavarur dhe autonomisë e profesionistëve.

Po ashtu, projektligji në fjalë përcakton mbrojtjen dhe garantimin e standardeve për disa profesione të rëndësishme, në mënyrë që ushtrimi i detyrave të tyre të bëhet vetëm nga personat e kualifikuar.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Arsim Bajrami është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Nait Hasani, në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport; Bekim Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Salih Morina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Slavko Simiq, në emër të Grupit Parlamentar LS, dhe Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin nr. 05/L-066 për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport si dhe Komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij projektligji dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë.

Ministri Arban Abrashi tha se me këtë projektligj synohet të rregullohet statusi juridik i bashkësive fetare, pa të cilin një grup fetar nuk mund të zotërojë ose të ushtrojë të drejtat e tij të cilat lidhen me statusin juridik të entitetit, siç janë: e drejta e zotërimit të pronës, mbajtja e llogarisë bankare, punësimi i punëtorëve, mbrojtja ligjore e komunitetit, e anëtarëve dhe pasurisë së komunitetit.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Arban Abrashi është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Lirije Kajtazi, në emër të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Mexhide Mjaku-Topalli, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Slavko Simiq, në emër të Grupit Parlamentar LS, dhe Kujtim Paçaku, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Shpejtim Bulliqi, Labinotë Demi-Murtezi, Gëzim Kelmendi, Nait Hasani, Sabri Hamiti dhe Melihate Tërmkolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari në vazhdim sqaroi se, duke u bazuar në nenin 81, amendamenti 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për miratimin e këtij projektligji kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë në shumicë.

Pra, nevojiten, të paktën 61 vota për, përfshirë këtu edhe të paktën 11 vota për të komuniteteve tjera.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 37,
Kundër ----- 12,
Abstenime ----- 20.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Nuk miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-065 përndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për Lirinë fetare në Kosovë.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Ministri Arban Abrashi tha se ky projektligj do t'i eliminojë pengesat dhe vështirësitë e identifikuar të ligjit aktual, përkatësisht dispozitat që kanë të bëjnë me mandatin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, ku do të përfshihen dispozitat me të cilat do të plotësohet dhe ndryshohet ligji në fuqi për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Arban Abrashi është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Selville Halimi, në emër të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit; Nezir Çoçaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Armend Zemaj,

në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Slavko Simiq, në emër të Grupit Parlamentar LS, dhe Danush Ademi, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin nr. 05/L-070 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij projektligji dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mjekësinë ligjore

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për mjekësinë ligjore.

Ministri Arban Abrashi tha se ky projektligj ka për qëllim rregullimin e procedurës për kryerjen e ekzaminimeve mjeko ligjore, themelimin dhe veprimtarinë e Agjencisë për Mjekësinë Ligjore.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Arban Abrashi është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Selvije Halimi, në emër të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit; Nezir Çoçaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Agim Ademaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Slavko Simiq, në emër të Grupit Parlamentar LS, dhe Danush Ademi, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për mjekësinë ligjore.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 63,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin nr. 05/L-060 për mjekësinë ligjore.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij projektligji dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për patentë shofer

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për patentë shofer.

Ministri Lutfi Zharku tha se miratimi i këtij projektligji është i domosdoshëm nga se rrit sigurinë në komunikacionin rrugor duke u bazuar në praktikat e Bashkimit Evropian.

Ky projektligj përcakton rregullat që duhen t'u përmbahen pjesëmarrësit në komunikacionin rrugor, çështjet që kanë të bëjnë me patentë shoferin, kushtet që duhet të plotësojnë rrugët dhe sinjalizimi rrugor, gjendjen teknike të mjetit, organizimin dhe mbikëqyrjen në komunikacionin rrugor si dhe masat e veçanta për kundërvajtje.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Lutfi Zharku është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Sasha Milosavljeviq, në emër të Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e paraqiti dhe arsyetoi para Kuvendit raportin me rekomandime, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për patentë shofer.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 63,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin nr. 05/L-060 për patentë shofer.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij Projektligji dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Ministri Hashim Thaçi tha se qëllimi i këtij projektligji është rregullimi i funksionimit të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës, i cili përfshinë Ministrinë e Punëve të Jashtme, misionet diplomatike, postet konsullore dhe nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës, si dhe çështjet tjera që ndërlidhen me funksionimin dhe veprimtarinë e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Hashim Thaçi është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Enver Hoxhaj, në emër të Komisionit për Punë të Jashtme; Elmi Reçica, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Sasha Milosavljeviq, në emër të Grupit Parlamentar LS, dhe Qerim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Vjosa Osmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 59,
Kundër ----- 5,
Abstenime ----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin nr. 05/L-061 për Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin Funksional për Punë të Jashtme, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij Projektligji dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Ministri Arban Abrashi tha se qëllimi i këtij projektligji është krijimi i një sistemi të mirëfilltë ligjor dhe efikas, në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Nëpërmjet këtij projektligji synohet të arrihet përmirësimi i infrastrukturës ligjore për promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Arban Abrashi është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Lirije Kajtazi, në emër të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione; Salihe Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Njomza Emini, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 64,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin nr. 05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik.

Kuvendie ngarkoi Komisionin Funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij projektligji dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për letërnjoftimin

Kryetari i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë projektligj dhe votimi i amendamenteve nga 1 deri me 8 kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur me 30 korrik 2015.

Ndërsa, në seancën e sotme kryetari procedoi me votimin e amendamentit 9, si dhe të tekstit të projektligjit me amendamentet miratuara.

Në lidhje me këtë projektligj diskutoi deputeti Nait Hasani, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Kuvendi e miratoi amendamentin nr. 9.

Më tej, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 62,
Kundër ----- 3,
Abstenime ----- 3 .

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin nr. 05/L-015 për letërnjoftimin.

18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimet

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funksional Raportues për Projektligjin për sigurimet.

Kryetari propozoi që të gjitha amendamentet nga 1-46 të votohen në pako.

Kuvendi nëpërmjet një votimi formal e miratoi propozimin e kryetarit.

Kuvendi i miratoi të gjitha amendamentet nga 1-46.

Më tej, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 62,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-045 për sigurimet.

19. Zgjedhja e një (1) anëtarit të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryetari në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës tha se Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës i ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit serb dhe Kuvendit ia ka paraqitur rekomandimin për miratim.

Në emër të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, deputetja Xhevahire Izmaqi para deputetëve të Kuvendit, paraqiti dhe arsyetoi rekomandimin e Komisionit ad hoc.

Kryetari më pas i njoftoi deputetët se në pajtim me nenin 26 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës dhe me rekomandimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtarit të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit serb. Kuvendi duhet ta zgjedhë me votim të fshehtë një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga dy të propozuar, me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë.

Më tej, kryetari sqaroi se për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të Administratës dhe i ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Grupet parlamentare propozuan këta anëtarë:

1. GP PDK - Blerta Deliu,
2. GP LDK - Salih Morina,
3. GP “Vetëvendosje” - _____,
4. GP AAK - _____,
5. GP LS – Bojan Mitiq,
6. GP “Nisma” - _____,
7. GP “6+” - Qerim Bajrami.

Kuvendi e miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Në vazhdim, deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti Blerta Deliu-Kodra.

Ajo konstatoi se në votim morën pjesë 71 deputetë, ndërsa të pavlefshme ishin 5 fletëvotime.

Rezultati i votimit është, si në vijim:

1. Ivan Veljković i ka fituar 55 vota
2. Mariana Adamović-Simić i ka fituar 11 vota.

Kryetarja e Komisionit votues konstatoi se kandidati Ivan Veljković zgjidhet anëtar i Bordit të RTK-së nga radha e komunitetit serb.

Kryesuesi Xhavit Haliti konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e anëtarit të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Z. Ivan Veljković emërohet anëtar i Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës me mandat tre (3) vjeçar.

20. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit të posaçëm për zgjedhjen e dy gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Kryetari informoi deputetët se Komisioni i posaçëm, në bazë të nenit 6 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ka zhvilluar të gjitha procedurat e parapara me ligj për përzgjedhjen kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe Kuvendit ia ka paraqitur për votim listën e ngushtë me katër (4) kandidatë.

Ndërsa, Kuvendi, prej katër kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, propozon dy (2) kandidatë, për emërim nga Presidentja e Republikës së Kosovës.

Kryetari, më pas i njoftoi deputetët me procedurat e votimit për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ndërsa theksoi se votimi do të jetë i fshehtë.

Sipas nenit 114, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, propozimi kandidatëve për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë.

Më tutje, kryetari tha se për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë, kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të administratës, dhe ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare, që të propozojnë nga një anëtarë për Komisionin votues.

Grupet parlamentare propozuan këta anëtarë:

1. GGP PDK - Rafet Rama,
2. GP LDK - Salih Morina,
3. GP Vetëvendosje - _____,
4. GP AAK - _____,
5. GP LS - Sërgjan Popović,
6. GP "Nisma" - _____;
7. GP "6+" - Kujtim Paçaku.

Kuvendi e miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Në vazhdim, deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti Rafet Rama. Ai konstatoi se në votim morën pjesë 79 deputetë, ndërsa të pavlefshme janë 5 fletëvotime.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

1. Gresa Cakaj-Nimani ika fituar 58 vota,
2. Rexhep Gashi i ka fituar 10 vota,
3. Selvete Gërxhaliu i ka fituar 46 vota,
4. Hashim Çollaku i ka fituar 23 vota.

Rafet Rama konstatoi se Gresa Cakaj-Nimani i propozohet Presidentes së Republikës për emërim gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese.

Ndërsa, në rundin e dytë të votimit garojnë:

1. Selvete Gërxhaliu dhe
2. Hashim Çollaku.

Rundi i dytë i votimit

Në vazhdim, deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti Rafet Rama. Ai konstatoi se në votim morën pjesë 79 deputetë ndërsa të pavlefshme janë 4 fletëvotime.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

1. Selvete Gërxhaliu i ka fituar 66 vota,
2. Hashim Çollaku, ka fituar 9 vota.

Rafet Rama konstatoi se Selvete Gërxhaliu i propozohet Presidentes së Republikës për emërim gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Për propozimin e dy (2) gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

1. Znj. Gresa Cakaj-Nimani dhe znj. Selvete Gërxhaliu propozohen gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.
2. Vendimi i dërgohet Presidentes së Republikës së Kosovës për emërim dhe për dhënien e betimit para Presidentes.

21. Emërimi i kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Kryesuesi Xhavit Haliti tha se Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me nenin 69.5 të Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar propozimin e Komisionit për për zgjedhjen për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Naser Osmani, kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, e paraqiti dhe e arsyetoi para Kuvendit raportin me rekomandime.

Më pas, kryesuesi e hodhi në votim propozimin për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 58,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Emërohen kryesuesi dhe anëtarët e Bordit Drejtues të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, si në vijim:

1. Ymer Havolli, kryesues
2. Frederick Artesani, anëtar,
3. Behxhet Haliti, anëtar,
4. Joly Dixon, anëtar dhe
5. Ruzhdi Morina (anëtar për përfaqësimin dhe këshillimin e punonjësve apo përfaqësuesve të tyre).

II. Mandati i të emëruarve nga pika I. e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.

22. Emërimi i anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas

Kryesuesi Xhavit Haliti tha se Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 11 dhe 12.3, të Ligjit nr. 04/L-017 për ndihmë juridike falas, i ka shqyrtuar propozimet lidhur me emërimin e anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas, dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Selvije Halimi, nënkryetare e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, e paraqiti dhe e arsyetoi para Kuvendit raportin me rekomandime.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim propozimin për emërimin e anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 58,
Kundër ----- 4,
Abstenime ----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Anëtarë të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas emërohen:

1. Baki Gimolli - Ministria e Drejtësisë,
2. Feim Osmani - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale,
3. Milena Vuçiq - Ministria për Komunitete dhe Kthim,
4. Enis Spahiu - Ministria e Financave,
5. Safet Voca - Oda e Avokatëve të Kosovës,
6. Valon Totaj - Gjykata Supreme e Kosovës,
7. Adem Lushaj - Organizata joqeveritare.

II. Mandati i anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas zgjat tre (3) vjet.

23. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Konsullor, të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës

Kryesuesi Xhavit Haliti i njoftoi deputetët për raportin me rekomandimet të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Konsullor, të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.

Deputetja Blerta Deliu-Kodra, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Jashtme, e paraqiti dhe arsyetoi para deputetëve raportin me rekomandime lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Konsullor, të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.

Diskutimi i deputetes Blerta Deliu-Kodra është dhënë i plotë ne transkript.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e raportit të lartpërmendur.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi deputeti Nait Hasani, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim raportin me rekomandime të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Konsullor, të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 60,
Kundër ----- 4,
Abstenime ----- 6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi raportin me rekomandime të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Konsullor, të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.

24. Shqyrtimi i raportit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2014

Kryetari i njoftoi deputetët se raportin e Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2014 e ka shqyrtuar Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Deputeti Muhamet Mustafa e paraqiti dhe arsyetoi para Kuvendit raportin me rekomandime në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri. Fjala e deputetit Muhamet Mustafa është dhënë e plotë në transkript.

Kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e raportit të lartpërmendur.

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati deputetë tjerë të interesuar për diskutim.

Kryetari e hodhi në votim raportin e Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2014, bashkë me Rekomandimet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 65,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi raportin e Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2014, bashkë me rekomandimet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

25. Shqyrtimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015

Kryetari i njoftoi deputetët se raportin për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015 e ka shqyrtuar Komisioni FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ministri Ferid Agani, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në cilësinë e propozuesit të çështjes, e paraqiti dhe arsyetoi para Kuvendit raportin për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015.

Deputeti Fikrim Damka e paraqiti dhe arsyetoi para Kuvendit raportin me rekomandime në emër të Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor. Fjala e Ministri Ferid Agani dhe deputetit Fikrim Damka është dhënë e plotë në transkript.

Kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e raportit të lartpërmendur.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Emilija Rexhepi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Adem Salihaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, si dhe Nait Hasani, Bekim Haxhiu dhe Adem Grabovci, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e hodhi në votim raportin për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 30,
Kundër -----27,
Abstenime ----- 5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi raportin për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015.

26. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për personat e verbër

Kryetari i njoftoi deputetët për raportin me rekomandimet të Komisionit FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për personat e verbër.

Deputetja Salihe Mustafa, në emër të Komisionit FunkSIONAL, e paraqiti dhe arsyetoi para deputetëve raportin me rekomandime lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për personat e verbër.

Diskutimi i deputetes Salihe Mustafa është dhënë i plotë ne transkript.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e raportit të lartpërmendur.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Mexhide Mjaku-Topalli, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe Etem Arifi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e hodhi në votim raportin me rekomandime të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për personat e verbër.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi raportin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për personat e verbër.

27. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014

Kryetari i njoftoi deputetët se raportin vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014 e ka shqyrtuar Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e raportit të lartpërmendur.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Ali Sadriu, në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike; Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, si dhe Arben Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e hodhi në votim raportin vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 62,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi raportin vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014.

28. Shqyrtimi i rekomandimeve lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Integritetit Evropiane për vitin 2014

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar raportin e Auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Integritetit Evropiane, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014, dhe Kuvendit ia ka paraqitur propozim-rekomandimet për shqyrtim dhe miratim.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës.

Ali Sadriu, në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, i paraqiti dhe i arsyetoi para Kuvendit propozim-rekomandimet lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Integritetit Evropiane për vitin 2014.

Kryetari i hodhi në votim propozim-rekomandimet e Komisionit Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Integritetit Evropiane për vitin 2014.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 58,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i miratoi rekomandimet e Komisionit Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Integritetit Evropiane për vitin 2014.

29. Shqyrtimi i rekomandimeve lidhur me raportin e auditimit të performancës për mirëmbajtjen dhe servisimin e veturave zyrtare, si dhe raportit të auditimit të pasqyrave financiare për Ministrinë e Administratës Publike, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Doganën e Kosovës dhe Policinë e Kosovës për vitin 2014

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar raportin e auditimit të performancës për mirëmbajtjen dhe servisimin e veturave zyrtare, si dhe raportit të auditimit të pasqyrave financiare për Ministrinë e Administratës Publike, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Doganën e Kosovës dhe Policinë e Kosovës për vitin 2014 dhe Kuvendit i ka paraqitur propozim-rekomandimet për shqyrtim dhe miratim.

Kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e këtyre propozim-rekomandimeve.

Ali Sadriu, në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, i paraqiti dhe i arsyetoi para Kuvendit propozim-rekomandimet lidhur me raportin e auditimit të performancës për mirëmbajtjen dhe servisimin e veturave zyrtare, si dhe raportit të auditimit të pasqyrave financiare për Ministrinë e Administratës Publike, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Doganën e Kosovës dhe Policinë e Kosovës për vitin 2014.

Kryetari i hodhi në votim propozim-rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike në lidhje me çështjen e lartpërmendur.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 60,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i miratoi rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin e auditimit të performansës për mirëmbajtjen dhe servisimin e veturave zyrtare, si dhe raportit të auditimit të pasqyrave financiare për Ministrinë e Administratës Publike, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Doganën e Kosovës dhe Policinë e Kosovës për vitin 2014.

30. Shqyrtimi i rekomandimeve lidhur me raportin e auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014

Kryetari i njoftoi deputetët se raportin vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014 e ka shqyrtuar Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike, e ka shqyrtuar Raportin vjetor të auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e propozim-rekomandimeve së bashku me Raportin vjetor të auditimit për vitin 2014.

Ndërsa, Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e propozim-rekomandimeve lidhur me raportin e auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014.

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati deputetë të interesuar për diskutim.

Kryetari i hodhi në votim propozim-rekomandimet Komisioni FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike së bashku me raportin vjetor të auditimit për vitin 2014.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 64,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i miratoi rekomandimet e Komisioni FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike së bashku me Raportin vjetor të auditimit për vitin 2014.

31. Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me pozitën aktuale të prodhuesve dhe përpunuesve në industrinë e qumështit

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, njëzëri ka vendosur që Kuvendit t'ia paraqesë propozim-rekomandimet lidhur me pozitën aktuale të prodhuesve dhe përpunuesve në industrinë e qumështit, duke rekomanduar miratimin e tyre.

Kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e propozim-rekomandimeve lidhur me këtë çështje.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Muhamet Mustafa, Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, ministria Hykmete Bajrami, Besim Beqaj dhe Gëzim Kelmendi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari i hodhi në votim propozim-rekomandimet e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në lidhje me çështjen e lartpërmendur.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 60,

Kundër ----- 1,

Abstenime ----- 7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i miratoi rekomandimet e Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me pozitën aktuale të prodhuesve dhe përpunuesve në industrinë e qumështit.

32. Kërkesa e kryetarit të Komunës së Prishtinës për dhënien e pëlqimit për rinovimin e sheshit “Adem Jashari” në Prishtinë

Kryetari i njoftoi deputetët se Komuna e Prishtinës ka planifikuar të bëjë rinovimin e sheshit “Adem Jashari”, që gjendet ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe Kuvendit të Kosovës. Por, meqenëse prona në të cilën gjendet sheshi figuron si pronë e Komunës së Prishtinës dhe e Kuvendit të Kosovës, për të vazhduar me procedurat e prokurimit, kryetari i Komunës së Prishtinës e ka kërkuar nga Kuvendi i Kosovës një pëlqim formal për rinovimin e tij.

Ky projekt bëhet në bashkëpunim me Projektin DEMOS, i financuar nga Qeveria zvicerane.

Kryetari e hapi debatin lidhur me këtë çështje.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Ganimete Musliu, Ismet Beqiri, kryetari Kadri Veseli, kryeministri Isa Mustafa, zv/kryeministri, Hashim Thaçi, Sabri Hamiti, Arben Gashi, Bekim Haxhiu, Armend Zemaj, Shpejtim Bulliqi, Adem Salihaj, Adem Grabovci dhe Myfera Shinik, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari i hodhi në votim propozimet e dala nga seanca plenare për formimin e një komisioni të Kuvendit, i cili do të bisedonte me udhëheqjen komunale të Prishtinës lidhur me këtë çështje dhe lidhur me vendosjen e përmendores së Komandantit Legjendar Adem Jashari në këtë shesh.

Kuvendi nëpërmjet një votimi formal me ngritje dore e miratoi propozimin për formimin e komisionit të Kuvendit lidhur me çështjet e lartpërmendura.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit ad hoc për të biseduar me zyrtarët e Komunës së Prishtinës për ndërtimin e “Sheshit të Lirisë - Adem Jashari”, në Prishtinë

I. Anëtarë të Komisionit ad hoc emërohen:

1. Naser Osmani, kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa,
2. Ganimete Musliu, deputete,
3. Nait Hasani, kryetar i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport,
4. Fikrim Damka, kryetar i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor,
5. Ferid Agani, ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

II. Komisioni autorizohet që të bisedojë me zyrtarët e Komunës së Prishtinës për hartimin e projektit të hollësishëm dhe koston buxhetore për ndërtimin e “Sheshit të Lirisë - Adem Jashari, në hapësirën ndërmjet Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe vendosjen e shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari.

III. Komisioni pas përfundimit të projektit duhet t’ia paraqesë Kuvendit propozim-vendimin për dhënien e pëlqimit për ndërtimin e “Sheshit të Lirisë - Adem Jashari”.

33. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryetari në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kërkoi nga grupet parlamentare që ta propozojnë kryesuesin, zëvendëskryesuesit dhe anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës. Fjala e kryetarit është dhënë e plotë në transkript.

Pas paraqitjes së propozimeve nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare, kryetari i hodhi në votim propozimet për kryesues, zëvendëskryesues dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës në këtë përbërje:

1. Xhevahire Izmaqi nga GP PDK, kryesuese,
2. Doruntinë Maloku nga GP LDK, zëvendëskryesuese e parë,
3. Nenad Rashiq nga GP LS, zëvendëskryesues i dytë,
4. Zenun Pajaziti nga GP PDK, anëtar,
5. Armend Zemaj nga GP LDK, anëtar,
6. _____ nga GP “Vetëvendosje”, anëtar,
7. _____ nga GP AAK, anëtar
8. _____ nga GP “Nisma”, anëtar dhe
9. Fikrim Damka nga GP “6+”.

II. Komisioni ad hoc, në bazë të nenit 26 pika 2.3 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, duhet t’i shqyrtojë dhe t’i përzgjedhë kandidaturat e paraqitura për anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

34. Propozimi i GP të Listës serbe për zëvendësimin e anëtarëve në komisione parlamentare

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar Lista Serbe i ka propozuar zëvendësimet në komisionet parlamentare.

Ai kërkoi nga deputetët që nëpërmjet një votimi formal me ngritje dore të deklarohen për propozimin e Grupit Parlamentar Lista Serbe.

Kuvendi, me propozim të Grupit Parlamentar Lista Serbe, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputeti Nenad Rashiq emërohet nënkryetar i dytë në Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, në vend të deputetit Slavko Simiq,
2. Deputeti Nenad Rashiq emërohet anëtar në Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare për Inteligjencë, në vend të deputetit Slavko Simiq.

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare në orën 23:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

*E përgatiti: Selman Ymeri,
zyrtar i lartë ligjor*